



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA / MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës , Nr.06/L-114, Ligjin për Institucionet e Kulturës, Ligjin Nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, Statutin e Baletit Kombëtar të Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Drejtor

Institucioni: Baleti Kombëtar i Kosovës

Kategoria funksionale / Koeficienti: 10

Numri i referencës: RN00007791

Kodi: RPC0001602

I përgjigjet: Këshillit Drejtues të Baletit Kombëtar të Kosovës

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Këshillit Drejtues të Baletit Kombëtar të Kosovës, përmbushë detyrat e poshtëshënuara:

1. Udhëheq punën e Baletit Kombëtar të Kosovës;

2. Përfaqëson dhe përgjigjet për veprimtarinë financiare si dhe ligjshmërinë dhe afarizmin e Baletit Kombëtar të Kosovës;
3. Miraton programin vjetor të punës me pëlqimin paraprak të Këshillit Drejtues;
4. Zbaton vendimet e Këshillit Drejtues;
5. Propozon dhe nxjerr aktin për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe aktin për shpërndarjen e pagave, të cilin e miraton Këshilli Drejtues;
6. Merr vendime në lidhje me marrëdhënien e punës së punëtorëve në pajtim me ligjin;
7. Në rast të moszgjdhjes së Udhëheqësit Artistik, me propozim të Këshillit Artistik, mund të emërojë ushtruesin e detyrës së Udhëheqësit Artistik, me afat deri në (6) muaj;
8. Ka të drejtë dhe detyrë të merr pjesë në punën e Këshillit Drejtues dhe komisioneve e trupave të tjera, pa të drejtë vote;
9. Mbikëqyr punën dhe aktivitetet artistike të trupave artistike dhe këshillëdhënëse (të përhershme dhe të përkohshme), në pajtim me Ligjin për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës Nr .02/ L-59;
10. Kryen edhe punë të tjera lidhur me ecurinë e punëve të Baletit Kombëtar të Kosovës, në pajtim me ligjin e lartcekur dhe me akte të tjera nënligjore.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë

1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë:

- 1.1 të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Drejtor i Baletit Kombëtar të Kosovës, zgjedhet personi me përgatitje profesionale universitare në fushën e artit dhe të kulturës.
2. Duhet të ketë shtatë (7) vite përvojë pune, duke përfshirë katër (4) vite përvojë pune në vende udhëheqëse;
3. Ka njohuri të mjaftueshme për veprimtarinë e institucionit;
4. Ka aftësi/shkathtësi organizative dhe menaxheriale të punës;
5. Drejtori i Baletit Kombëtar zgjedhet me mandat me kohëzgjatje tri (3) vite;
6. Personi i njëjtë mund të rizgjedhet;

7. Kërkohe të posedojë aftësi të shkëlqyeshme komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
8. Të njohë mirë gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës;
9. Të ketë aftësi të avancuara të njohjes së punëve me kompjuter;
10. Të ketë aftësi për të kontribuar në grupe punuese;
11. Vërtetimin që nuk është nën hetime.

Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë mandatin: Ligji për Zyrtarët Publik, Nr.06/L-114, Ligji për Institucionet e Kulturës, Ligji Nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, Statutin e Baletit Kombëtar të Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej dt. 26.10.2021 deri me dt.24.11.2021, ndërsa data e aplikimit është nga data 25.11.2021 deri me datën 09.12.2021.

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në Web faqen e MKRS-se.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit , ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil e administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numri1 038211449 dhe 038 211921(apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).